



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:076163
Datë: 27.02.2025
Numri i dokumentit: 06913276

Ac.nr.7111/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj - kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Malsor Kryeziu - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses F.U. nga Gj., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.I. avokat nga Gj., kundër të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i diferencës në pagë në emër të kuaifikimit sipas gradës shkencore master, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2381/2024, të datës 08.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 26.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2381/2024 i datës 08.05.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.2381/2024, të datës 08.05.2024, ka vendosur si në vijim:

“I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses F.U. nga Gj. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan që paditëses në emër të kërkesës për kompensim të diferencës së pagës mbi bazën e kualifikimit – lëvizje në gradim-Master që përcillet me ngritje page 35 % të pagës bazë për periudhën kohore nga data 05.10.2021 e deri më datën 05.02.2023, për 16 muaj, t’ia paguaj shumën nga 106.53 euro, për një muaj, respektivisht shumën prej 1,704.48 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e

paraqitjes se padisë (datë 07.03.2024) e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia paguaj paditësit shumën 135 €, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.”

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë për shkak të, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën ndërsa aktgjykimin e atakuar ta prish, të refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë, ta prishë aktgjykimin dhe t'a kthej rastin në rigjykim/rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësja.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, duke kërkuar që të obligohet e paditura në kompensimin mbi bazën e kualifikimit, me arsyet sikurse në padi, e po ashtu duke kërkuar edhe kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pas marrjes së përgjigjes në padi dhe vlerësimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2381/2024, të datës 08.05.2024, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar te e paditura (fakt i vërtetuar edhe nga Vërtetimi me nr.të prot.03/14/24 i datsë 30.01.2024 lëshuar nga shkolla ku punon paditësja përem së cilës vërtetohet fakti se e njëjta ka përvojë pune në këtë shkollë 2 vite, nuk është kontestuese se paditësja i ka kërkuar në procedurë të rregullt administrative nga e paditura kompensimin e licencimit-gradimit, por e paditura ka heshtur, nuk është kontestuese se e njëjta për periudhën kohore janar 2021 e deri në shkurt 2023 nuk është kompensuar sipas Kontratës Kolektive-Vendimit të Qeverisë nr.01/33 të vitit 2008 për licencim, nuk është kontestues fakti se e njëjta pagën bazë e ka 421 euro (fakt ky i vërtetuar nga lista e pagave në emër të tij të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës), nuk është kontestus fakti se e njëjta ka të kryer Fakultetin e Shkencave Matematikë-Natyrore në Prishtinë dhe ka marrë titullin Master i Shkencave të Gjeografisë, (fak ky i vërtetuar nga Diploma me nr.të prot.1035 e datës 14 Prill 2021). Bazën ligjore për vendosje e ka mbështetur në Kontratën Kolektive të Arsimit të vitit 2017 dhe 2021, Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.214/2023 të datës 05.10.2023, si dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë,

të datës 18.04.2017, dhe të datës 22.01.2021. Vendimin mbi kamatën e ka bazuar në nenin 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 449, 452 dhe 453 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, ndërsa nuk qëndrojnë edhe pretendimet tjera të palës ankuese të cekura në ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës, kualifikimi dhe licencimi i paditëses.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsye se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive"*.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë, duke e detyruar të paditurën që paditëses t'iu paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar në emër të kompensimit për licencim me të drejtë është bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2017 dhe 2021, lidhur dhe nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), të cilat në mënyrë të qartë kanë paraparë se me licencim fitohet e drejta në punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi, e që në bazë të licencimit dhe kualifikimit të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.1. Mësimdhënës me Shkollë Normale 10% e pagës bazë, 1.2. Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë, 1.3. Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë, 1.4. Mësimdhënës

me diplomë 5 vjeçar, magistraturë/master dhe doktoraturë 35% e pagës bazë, 1.5.Përparimet në karrierë, caktohet lartësia e pagës dhe lëvizja në gradim që përcillet me ngritje page 10%.

Gjykata e shkallës së parë, po ashtu me të drejtë është bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimsdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimsdhënëseve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %. Se një e drejtë e tillë i takon palës paditëse, e ka sqaruar edhe Gjykata Supreme e Kosovës në mendimin juridik Gj.A.nr.214/2023, datë 09.10.2023.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes për kompensimin në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit për punonjësit me licencë, ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përputhje me provat e bashkangjitura shkresave të lëndës ka vërtetuar faktin se paditësja ka kualifikim master, paga bazë e të njëjtës është 421.00 euro, në emër të kualifikimit i është paguar në baza mujore shuma prej 40.82 euro, rrjedhimisht diferenca që duhet të paguhet është 106.53 euro për muaj, në shumën e përgjithshme prej 1704.48 euro, për periudhën 05.10.2021 – 05.02.2023, për 16 muaj gjithsej.

Lidhur me pretendimin tjetër të paditurës të parashtruar përmes ankesës, lidhur me parashkrimin e kërkesës sipas nenit 87 të Ligjit të Punës të gjykata e shkallës së dytë vlerëson se një pretendim i tillë është i paqëndrueshëm, pasi që nuk janë plotësuar kushtet ligjore, që kërkesa të konsiderohet e parashkruar në kuptim të nenit të lartcekur, pasi që padia dhe kërkesëpadia e paditëses është parashtruar brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Njëherazi, gjykata i ka vlerësuar të papranueshme pretendimet ankimore të paditurës, se nuk është paraparë me Ligjin e Punës apo se nuk është nënshkruese e kontratës kolektive, ngase i njëjti është paraparë me dispozitat e KKAK-së, nënshkruese e të cilës është edhe MASHT-i, andaj e paditura nuk lirohet nga obligimi për pagesën e shumave të gjykuara, sepse kontratat e nënshkruara në mes palëve kanë bazë ligjore në LMD-në, dispozitat përkatës të këtij ligji neni 7 që e rregullojnë materien e çështjes së kontratës, si dhe konform nenit 8 par.1 të LMD-së, ku shprehimisht thuhet "Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit".

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së dhe tarifës së OAK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 7111/2024, datë 26.02.2025

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj d.v.